



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 114/951
Dt. Rregj. 16.06.2014

Nr. Vendimi 40
Dt. Vendimi 21.01.2015

V E N D I M
"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Albana Palaj, sot me date 21.01.2015, ora 12.30,mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore çeshtjen administrative me Rregj.Them.114/951 datë 16.06.2014 me pale ndergjyqese:

PADITES: Ardjan Ymeraj , Adminisrator me nr Nipt L27120001 A me adrese ne lgj.Q.Stafa, rr.J.Karamitri, Shkoder.

E PADITUR: Drejtoria e Pergjithshsme e Tatimeve,dega Shkoder,pefaqshuar nepërmjet znj. Siriana Bakushi, e autorizuar për përfaqsim me autorizim nr.10347/1 dt.16.01.2015
Drejtoria e Apelimit Tirane, perfaqshuar nga znj. Siriana Bakushi, e autorizuar për përfaqsim me autorizim nr.594 prot dt.12.01.2015

OBJEKTI: Anullimin e aktit Administrativ "Njoftim vlersimi Tatimor" me nr. Prot 482/2 dt 21.01.2014 i lene ne fuqi me vendimin nr.4372/3 dt 16.05.2014 te Komisionit te Apelimit Tirane.

BAZA LIGJORE: Neni 17/1/a/c i ligjit 49/2012 ligji 9920 dt 19.05.2008. Nenet 116,118 e vij te Kodit te Pr. Administrative

Gjykata ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi administroi provat shkresore te paraqitura, dhe pasi degjoi palen paditese z. Ardjan Ymeraj, i cili kerkoj perfundimisht pranimin e kerkese padise sipas objektit te saj, perfaqesuesen e paleve te paditura qe kerkoj rrezimin e kerkese padise si te pambeshtetur ne ligj dhe prova, shqyrtoi dhe analizoi çeshtjen ne teresi:

VEREN se

Paditësi Ardjan Ymeraj I është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur 1) Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër me objekt;

Anullimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimit tatimor nr.482/2 prot datë 21.01.2014, i lënë në fuqi me vendimin nr.4372/3 prot datë 16.05.2014 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë

Subjekti "Ardjan Ymeraj" është i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me numër Nipti L27120001A, me objekt aktiviteti "shërbim mjekësor.....".

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me njoftim-vlerësimin nr.482/2 prot datë 21.01.2014, me detyrime, gjobë në vlerën 250.000 lekë, periodha tatimore 2013/10, dënim për punonjës të padeklaruar .

Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me shkresën nr.246 prot datë 17.12.2013, protokolluar pranë saj me nr.11575 prot date 30.12.2013, i është komunikuar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës Drejtoria Rajonale Shkodër praktika, Proçesverbali datë 16.10.2013 mbajtur për "mosdeklarim të një punonjësi", pranë subjektit tregtar privat "Ardjan Ymeraj" me numër Nipti L27120001A.

Bazuar në këtë praktikë nga struktura e Kontrollit tatimor, Sektori i verifikimit në terren është marrë masa administrative e gjobës, bazuar në Akt konstatimin me numër serial 0399006 datë 14.01.2014, mbajtur dhe Proçesverbal i i gjobës me numër 0064169 datë 14.01.2014.

Njoftim vlerësimi është nxjerrë në bazë të informacionit të komunikuar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës Drejtoria Rajonale Shkodër .

Në Akt inspektimin e mbajtur nga inspektorët e ISHP Drejtoria Rajonale Shkodër datë 16.10.2013 është përshkruar gjendja e konstatuar në vend gjatë verifikimit në subjekt dhe shprehet :

"Nga kontrolli i kryer u konstatuan tre punëmarrës gjithsejt, nga të cilët një punëmarrës i padeklaruar në organin tatimor, zj.Rediola Sterkaj".Mbi bazën e kësaj praktike nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër është mbajtur Akt konstatimi me numër serie 0399006 datë 14.01.2014 dhe Proçesverbali i gjobës me numër serial 0064169 datë 14.01.2014.

Subjekti rezulton të mos ketë pranuar të nënshkruajë aktet dhe nga inspektorët e kontrollit është lënë shënimi përkatës në rubrikën "Për tatimpaguesin", shënimi "Refuzon firmën".

Gjithashtu është bërë verifikimi i të gjithë punonjësve të deklaruar si "të punësuar" nga subjekti "Ardjan Ymeraj" me numër nipti L27120001A para organit tatimor, detyrim ligjor ky për të, për periudhën tatimore në fjalë.Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur është vlerësuar, se punonjësja e gjendur në punë, zj.Rediola Sterkaj nuk është deklaruar në organin tatimor nga subjekti apo nuk rezulton të jetë përfshirë në deklarim në Tax-Crm sipas "Listë pagesës së deklaruar" për periudhën tatimore tetor/2013, sipas Formularit "E-Sig 025-Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi".Me shkresën nr.11595/1 prot datë 15.01.2014 Drejtoria e kontrollit, njofton Drejtoria e Menaxhimit të të Ardhurave, pranë Drejtorisë Rajonale në lidhje me masën e marrë ndaj subjektit.

Me shkresën nr 7.prot dt 10.01.2014 miratuar nga drejtori drejtorise rajonale te tatimeve Shkoder eshte leshuar urdheri I punes per Fation Dibra e Kreshnik Dibra ,inspektor ne terren , te ushtrojne kontroll tek tatimpaguesi Adrian Ymeraj, me objekt kontrolli nder te tjera dhe – *Deklarimi I te punesuarve* -.

Kontrolli do te ralizohet nga ora 08.00 deri ne oren 16.00 te dt 10.01.2014.

Nga Kontrolli tatimor, Sektori i verifikimit në terren është marrë masa administrative e gjobës, bazuar në Akt konstatimin me numër serial 0399006 datë 14.01.2014, mbajtur dhe Proçesverbal i i gjobës me numër 0064169 datë 14.01.2014.



Nga vete provat e nenshtruar shqyrtimit gjyqsore rezultoi se kontrolli i inspektorëve nuk është bërë në orën dhe datën e përcaktuar në program kontrollin që është dt 10.01.2014 por është bërë me dt 14.01.2014, jashtë datës së përcaktuar në program, për pasoje çdo veprim i inspektorëve jashtë kriterëve të përcaktuar në urdherin e punës nr 7 /prot dt 10.01.2014 i bëjnë veprimet e pavlefshme, për pasoje dhe aktet e dalë në përmbushje të këtyre veprimeve janë absolutisht të pa vlefshme.

Përfundimisht gjykata nga sa më sipër analizoi vendosi pranimin e kërkesës padisë, prandaj,

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 45 pika a të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"

VENDOSI

Pranimin e kërkesës padisë.

Shfuqizimin e aktit administrative njoftim vleresimi administrativ nr.482/2 prot datë 21.01.2014, i lënë në fuqi me vendimin nr.4372/3 prot datë 16.05.2014 të Drejtorisë së Apelit të Tiranës

Shpenzimet gjyqsore sic janë bërë.

Kunder vendimit nuk lejohet ankim, është i formës së prerë.

Shkoder me date 21.01.2015

SEKRETARE SEANCE

Albana HALAJ



GJYOTARE

Valbona DURRAJ